


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. Prot. 4581
3

Tiranë, më 18/12/2019

VENDIM

Nr. 43 datë... 18.12.2019

PËR

NGRITJEN E NJËSISË SË KËRKIM-STUDIMIT NË FUSHËN E NANO-SHKENCËS DHE NANO-TEKNOLOGJISË

Në mbledhjen e saj të datës 18 dhjetor 2019 Kryesia e ASH, mbështetur në nenet 19 të ligjit nr. 53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë" dhe 45 të Statutit të ASH, me pëlqimin e dhënë prej Seksionit të Shkencave Natyrore Teknike, projektin e paraqitur nga akad. Arben Merkoçi, me kërkesë të Kryetarit akademik Skënder Gjinushi,

V e n d o s i:

1. Të ngrejë pranë ASH një njësi të kërkim-studimit në fushën e nano-shkencës e nano-teknologjisë.
2. Njësia të përbëhet nga akad. Arben Merkoçi, drejtues shkencor i njësisë, prof. Kledi Xhaxhiu (Universiteti i Tiranës), prof. Majlinda Vasjari (Universiteti i Tiranës), anëtarë dhe një koordinator.
3. Objekti i punës është realizimi i angazhimeve të përcaktuara në projektin e paraqitur nga akad. Arben Merkoçi (bashkëngjitur).
4. Veprimtaria e njësisë do të synojë koordinimin e kërkimit shkencor në fushën e nano-shkencës e nano-teknologjisë, evidentimin e gjendjes aktuale të kërkimit në Shqipëri e rajon në nivel shkencor, logjistik e kapacitete intelektuale, zhvillimi i konferencave kombëtare e ndërkombëtare në këtë fushë, aplikimi për tërheqje projektsh evropiane, vendosja e bashkëpunimit me qendra homologe të kërkimit, riorganizimin e saj deri në konsolidimin si një qendër reale e kërkimit shkencor.
5. Koha e veprimtarisë është deri në 2 vjet.
6. Pranë njësisë do të ftohen si anëtarë bordi e konsulentë, bashkëpunëtorë shkencorë e kërkues, ndër më të njohurit në këto fusha, sipas propozimit të drejtuesit të njësisë.

7. ASH siguron mbështetjen logjistike dhe mbulon shpenzimet financiare për veprimtarinë e njësisë.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI

